

Lënda: Kthim përgjigje

Z. Imer Sinani

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të regjistruar me nr. 896 prot., datë 03.02.2023, ju sqarojmë se:

Në bazë të dokumentave që disponon Drejtoria e Arkivit Qendror të sigurimeve shoqërore është kryer shfletimi fizikisht i dy regjistrave themeltar të Kooperativës Bujqësore Pac, fshati Pac, i një regjistri themeltar të Kooperativës Bujqësore Pac, fshati Vlad dhe një regjistëri indeks të Kooperativës Bujqësore fshat i përgjithshëm. Nga shfletimi i regjistrave themeltar të vjetërsisë në punë rezulton se, emri juaj (Imer Islam Sinani) nuk figuron.

Në këto kushte, verifikimet kanë vijuar në Degën Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tropojë. Në vërtetimin negativ nr. 119 prot, datë 10.02.2023 të lëshuar nga kjo degë konfirmohet se, nga verifikimi i sistemit të vjetërsisë në punë nuk figuron asnjë person me gjeneralitetet Imer Islam Sinani. Gjithashtu në këtë vërtetim sqarohet se, arkivi i Degës Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tropojë nuk administron bordero për Kooperativën Bujqësore Pac, për periudhën 1979 - 1982.

Bazuar në nenin 31, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se: *personat e siguruar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92 të po këtij ligji.*

Ju jeni i datëlindjes 16.03.1959 dhe referuar nenit 92 të drejtën për të përfituar pension pleqërie e plotësoni në datën 16.03.2024, në moshën 65 vjeç.

Nëse plotësoni kushtet e kërkuara në ligj, në momentin e plotësimit të moshës për pension duhet të aplikoni me kërkesën për caktim pensioni pleqërie. Aplikimi bëhet on-line në portalin e-Albania, tek shërbimi "Aplikim për pension pleqërie, suplementar pilot, suplementar lundruer i nëndetëseve apo suplementar për akademik" në zbatim të neneve 31, 32, 92, 95, të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993. Në aplikim duhet të deklaroni saktë të gjitha periudhat e punësimit sipas ndërmarrjeve/subjekteve ku keni punuar.

Mënjëherë pas aplikimit, dokumentat origjinale të pensionit sëbashku me kopjen e aplikimit, duhet të dërgohen nëpërmjet shërbimit postar në adresë të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore të vendbanimit tuaj.

Strukturat rajonale të sigurimeve shoqërore do të vlerësojnë dokumentacionin dhe do t’ju informojnë në lidhje me caktimin e pensionit brenda afateve zyrtare konform legjislacionit në fuqi.

Bashkëngjitur shkresës sqaruese, gjeni vërtetimin përkatës në emër të z.Imer Islam Sinani.